



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
SHPËRNDARËS FARMACEUTIK
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA RAJONALE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I EKZEKUTIMIT
TE VENDIMEVE PENALE

Nr.	Prot	Datë	Nr.	Prot	Datë	Nr.	Prot.	Datë
-----	------	------	-----	------	------	-----	-------	------

K O N T R A T Ë

**“PËR RIMBURSIMIN E BARNAVE TË LËSHUARA DHE EKZEKUTUARA NË
INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR VITIN 2024”**

Ndërmjet

**DREJTORISË RAJONALE TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR _____**

Dhe

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE PENALE _____

Dhe

SHPËRNDARËSIT FARMACEUTIK _____

Kjo Kontratë nënshkruhet në _____, në datë _____

ndërmjet këtyre palëve:

1. Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor _____, (në vijim “DRF”) përfaqësuar nga Drejtori Z/Znj. _____;

2. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale _____ përfaqësuar nga Z./Znj. _____, (në vijim “IEVP”)

3. Shpërndarësit Farmaceutik, (në vijim “Shpërndarësi”), _____, me të dhënat e mëposhtme:

Kodi i identifikimit nga Fondi _____ ,
Liçencë të Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”) nr. _____,

Nr. llogarie bankare _____ në bankën _____,

NIPT/NUIS Nr. _____,

Adresë /Adresë sekondare _____

Nr. telefoni _____ adresa elektronike _____,

Person juridik/fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor, Z/Znj. _____
me drejtues teknik Z/Znj. _____ me çertifikatë të Urdhrit të Farmacistëve Nr. _____.

Dispozita paraprake

Duke qenë se:

A. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim FONDI), e zhvillon aktivitetin në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

B. Në bazë të ligjit të sipërcituar Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për dhënie e shërbimeve shëndetësore të përfshira në paketat e shërbimeve ku bën pjesë Lista e Barnave të Rimbursuara, (në vijim LBR), e miratuar nga Këshilli i Ministrave;

C. Shpërndarësi është njësi tregtare farmaceutike që tregton me shumicë barnat e Listës së Barnave të Rimbursueshme në bazë të ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”; i ndryshuar.

D. Shpërndarësi ka përmbushur kriteret për lidhjen e kontratave me Fondin si dhe ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar për lidhjen e kontratave, në përputhje me Vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 72, datë 22.12.2015, të ndryshuar;

E. Këshilli Administrativ i Fondit ka miratuar kontratën tip “Për qarkullimin e barnave të listës së barnave që rimbursohen nga shpërndarësi farmaceutik për vitin 2024”, me VKA nr. 13, datë 31.07.2024;

F. Kushtet e kësaj kontrate janë në vazhdimësi të marrëdhënieve të mëparshme sipas kontratave të lidhur që nga viti_____.

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është mbulimi i çmimit të alternativës së parë të barnave të Listës së Barnave që Rimbursohen (në vijim “LBR”) për personat e dënuar me burgim dhe të paraburgosur, nga skema e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, nëpërmjet plotësimit të recetave me rimbursim nga mjeku i IEVP-së dhe tregtimit nga ana e Shpërndarësit të këtyre barnave dhe shpërndarjes nga farmacia e IEVP-së për të sëmurët deri në daljen e tyre nga IEVP.

Neni 2

Baza ligjore

Për hartimin dhe zbatimin e kësaj kontrate palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore që vijon:

1. Ligji Nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar;
3. Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
4. Ligji Nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar;
5. Ligji Nr. 7975, datë 26.7.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar;
6. Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil”, i ndryshuar;
7. Ligji Nr. 7697 datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”;
8. Ligji Nr. 8615, datë 1.06.2000 “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Etikës dhe deontologjisë mjekësore;
9. Ligji Nr. 9718, datë 19.04.2007, “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
10. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

11. Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
12. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar;
13. Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
14. Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar;
15. Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
16. Ligji nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
17. Ligj nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar
18. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 857, datë 20.12.2006 “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar;
19. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 144, datë 11.02.2009 “Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregëtimit me shumicë të barnave, të tregëtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre”;
20. Vendimi i Këshillit Administrativ nr. 101, datë 22.10.2014, për miratimin e rregullores nr. 3, datë 22.10.2014, “Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin”;
21. Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 24.07.2024 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”.
22. Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 526, datë 12.10.2009, “Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor”;
23. Urdhri Nr. 128, datë 03.03.2010, të Ministrisë së Shëndetësisë “Për pajisjen e mjekëve dhe stomatologëve me lejen individuale për ushtrimin e profesionit”;
24. Urdhri Nr. 554, datë 22.10.2009, “Për miratimin e dokumentit rregullator për ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë”;
25. Urdhri Nr. 657, datë 15.12.2010, “Karta shqiptare e të drejtave të pacientit”.
26. Udhëzimi nr. 16, datë 03.04.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
27. Udhëzimi nr. 20, datë 01.06.2020, “Për elementet bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin faturave elektronike dhe faturave shoqëruese.

Neni 3

Detyrimet e Përgjithshme të IEVP

1. IEVP është përgjegjëse për organizimin e punës për qarkullimin e barnave me rimbursim në institucion.
2. IEVP është përgjegjëse për regjistrimin e të gjithë personave që kërkojnë shërbim shëndetësor në një regjistër “Tip” (Aneksi U1) nëpërmjet personelit mjekësor të këtij institucioni.
3. IEVP nëpërmjet mjekut të punësuar në institucion është e detyruar të hapë kartelë personale për të gjithë personat objekt i kësaj kontrate.

4. IEVP pajis DRF me listën e mjekëve që do të plotësojnë recetat me rimbursim. Sa herë ka ndryshime të mjekëve duhet të njoftojë me shkrim DRF.
5. IEVP duhet të njoftojë me shkrim DRF mbi të dhënat e personave objekt i kësaj kontrate, si gjeneralitetet, vendbanimin e mëparshëm, emrin e mjekut të familjes.
6. IEVP në ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj pacientëve duhet të zbatojë Sistemin e Referimit të Pacientit në Institucionet Shëndetësore Publike si dhe aktet ligjore dhe nenligjore të Ministrisë së Drejtësisë për levizjen e pacienteve kur kanë nevojë për trajtim me te specializuar.
7. IEVP të dorëzojë pranë DRF inventarin e gjendjes fizike të barnave, objekt i kësaj kontrate, në momentin e lidhjes së kësaj kontrate dhe sa herë që hyn në fuqi Lista e Re e Barnave të Rimbursueshme.
8. IEVP duhet t'i japë informacion Fondit/DRF për aktivitetin e kryer, objekt i kësaj kontrate sa herë që kërkohet.
9. Të pranojë kontrollin nga Fondi/DRF në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.
10. Të njoftojë me shkrim DRF për personat e larguar nga IEVP, dhe një fletë-dalje tip (Aneksi U2).
11. IEVP është e detyruar të plotësojë të gjitha kushtet e ruajtjes së barnave sipas rregullores së shërbimit farmaceutik dhe specifikës së tyre përfshirë standartet frigoriferike për ruajtjen e barnave termolabile, kondicionimin e ajrit si dhe të jete e pajisur me termometer për matjen e temperaturës së ambientit.

Neni 4

Detyrimet e mjekut të IEVP mbi kryerjen e vizitës dhe plotësimin e dokumentacionit

1. Mjeku të jetë anëtar i Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Mjeku duhet të ofrojë shërbimet shëndetësore në përputhje me legjislacionin për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, ligjin për kujdesin shëndetësor, Ligjin për barnat, protokollet profesionale të miratuara, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Urdhri i Mjekut dhe Urdhëri i Infermierit.
3. Për çdo vizitë të kryer të plotësojë dokumentacionin përkatës: regjistrin e vizitës, kartelën personale të pacientit, recetat, rekomandimet.
4. Të përcaktojë diagnozën dhe mjekimin e të sëmurit duke u mbështetur në udhërrëfyesit kombëtar të praktikës më të mirë klinike të miratuara, si dhe ta rekomandojë atë për ekzaminime apo konsulta të specializuara kur e gjykon të nevojshme, kundrejt zbatimit të sistemit të referimit në shërbimet shëndetësore.
5. Në të gjitha rastet kur kërkohet konsultë e specializuar, duhet të respektohet sistemi i referimit të pacientit në institucionet shëndetësore.
6. Të plotësojë rekomandimin për konsultim tek mjeku specialist kundrejt plotësimit të të gjithë elementëve të domosdoshëm, duke motivuar në mënyrë të qartë arsyet e dërgimit.
7. Të administrojë kartelën personale të të sëmurit, kundrejt plotësimit të të gjithë elementëve të domosdoshëm të saj, si gjeneralitetet, kodin e pacientit, anamnezën, ekzaminim objektiv

dhe subjektiv, data vizitës, ankesat, diagnozën, mjekimin, ekzaminimet laboratorike dhe imazherike dhe ecurinë e sëmundjes. Çdo vizitë, duhet të përshkruhet në kartelë: fletëdaljet, epikrizat përcjellëse, rekomandimet dhe ekzaminimet konfirmuese të diagnozës, të mbahen në kartelën e të sëmurit, duke bërë përshkrimin e tyre në kartelë.

8. Të gjithë të sëmurët kronikë, duhet të kenë të dokumentuar në kartelën personale konsultën e specialitetit përkatës, i cili duhet të jetë detyrimisht brenda sistemit shëndetësor publik të kontraktuar me Fondin.
9. Për mjekimin me rimbursim të të sëmurëve të mbështeten në Listën e Barnave të Rimbursuara, (në vijim “LBR”) aktet e Fondit, kufizimet e LBR dhe protokollat e përdorimit të barnave të miratuara.
10. Në rastet e largimit të pacientit nga IEVP, mjeku duhet ta pajisë me një epikrizë (rekomandim) ku të përshkruajë gjendjen aktuale të pacientit dhe trajtimin me barna të rimbursueshme.

Neni 5

Detyrimet e mjekut për lëshimin e recetës.

1. Të plotësojnë receta me rimbursim sipas formatit tip me të gjithë elementët e recetës sipas udhëzimit përkatës të Fondit, vetëm për pacientët objekt i kësaj kontrate.
2. Të përshkruajë një recetë me rimbursim të veçantë në muaj për çdo diagnozë dhe të vendosë saktë kodin e diagnozës. Kategorikisht mjekimi duhet të përputhet me diagnozën.
3. Të përshkruajë në recetën me rimbursim barnat me shkrim të mirë të kuptueshëm dhe vetëm me emrin xhenerik sipas listës së barnave të rimbursueshme.
4. Të vulosë me vulën personale dhe vulën e IEVP recetën me rimbursim.
5. Të lëshojë recetë të veçantë për barnat narkotike dhe psikotrope. Mjeku dorëzon recetat e plotësuara në farmacinë e institucionit.
6. Mjeku në bashkëpunim me drejtuesin e farmacisë mbështetur në nevojat mujore sipas recetave me rimbursim hartojnë listë-kërkesën e barnave, të cilën pas konfirmimit tek titullari, e paraqesin tek shpërndarësi farmaceutik i barnave i kontraktuar me Fondin për tërheqjen e barnave. Në listë-kërkesë barnat shënohen sipas emrit xhenerik të LBR.
7. Të ruajë deri në zhvleftësimin e tyre nga DRF, recetat me rimbursim të papërdorshme për shkak të defekteve, të plotësimit gabim e të tjera të kësaj natyre.

Neni 6

Detyrimet e farmacisë së IEVP

1. Farmacia IEVP duhet të jetë e pajisur me kompjuter për të realizuar kompjuterizimin e të dhënave sipas programeve të përgatitura nga Fondi.
2. Farmacia IEVP është e detyruar të marrë në dorëzim barnat, të pajisura me pullën e kontrollit të AKBPM, nga shpërndarësi farmaceutik i kontraktuar, sipas kërkesës së drejtorisë së IEVP-së dhe kundrejt faturave përkatëse të fiskalizuara.

3. Farmacia IEVP bën hyrje barnat në bazë të fletë-daljeve të shpërndarësit farmaceutik, të cilat përveç detyrimit sipas pikës 3, shkronja “c”, të nenit 7, (Detyrimet e shpërndarësit farmaceutik), të plotësojnë dhe kushtet e mëposhtme:
 - a) Të kenë vulën e shpërndarësit farmaceutik;
 - b) Të kenë firmën e dhënësit;
 - c) Të kenë emrin e marrësit (farmacisë);

Në qoftë se një nga kushtet e mësipërme nuk plotësohet fletëdalja nuk merret parasysh gjatë kontrollit me inventar.

4. Farmacia IEVP mban regjistrin vjetor tip të pajisur nga Fondi, në të cilin do të pasqyrojë të gjitha fletëdaljet e shpërndarësit farmaceutik brenda 5 ditëve nga data e lëshimit, në rastet kur kemi korrigjime në regjistrin vjetor të cilat përkojnë me korrigjimet në fletëdaljet e shpërndarësit farmaceutik atëherë këto fletëdalje nuk merren parasysh gjatë kontrollit me inventar.
5. Farmacia IEVP pranon recetat me rimbursim lëshuar nga mjekët e kontraktuar të IEVP vetëm për të burgosurit/paraburgosurit e rajonit ku IEVP ushtron aktivitetin.
6. Farmacia i jep barnat infermierit/ndihmësmjekut të caktuar të IEVP, për të burgosurit/paraburgosurit kundrejt dokumentacionit të mëposhtëm:
 - a) Receta me rimbursim të plotë;
7. Për dorëzimin e barnave nga farmacia tek infermieri/ndihmës mjeku mbahet një evidencë “Terapia ditore” (Aneksi U3), ku firmosin të dy palët.
8. Farmacia IEVP të ekzekutojë recetat saktësisht sipas udhëzimeve në fuqi, pasi në çdo rast të kundërt nuk do të rimbursohen recetat që kanë:
 - a) Mungesë emri, mbiemri të pacientit;
 - b) Mungesë diagnoze;
 - c) Mungesë date të lëshimit të recetës;
 - d) Mungesë vule mjeku;
 - e) Mungesë të kodit të diagnozës;
 - f) Mungesë e kategorizimit të pacientit;
 - g) Mungesë të datës së ekzekutimit të recetës, e cila duhet të jetë e njëjtë me atë të lëshimit;
 - h) Korrigjim të dozës së barit;
 - i) Korrigjim të sasisë së barit;
 - j) Korrigjim të principit aktiv së barit;
 - k) Mungesë vule të IEVP;
 - l) Në rast se receta nuk është e plotësuar saktë me elementët e mësipërm dhe është me korrigjime, kjo recetë nuk do të njihet për rimbursim.
9. Farmacia IEVP në vlerësimin e recetës zbaton çmimin e shpërndarësit farmaceutik (depo) të alternativës së parë të barit sipas LBR.
10. IEVP është e detyruar të paraqesë pranë DRF recetat me rimbursim së bashku me listëtreguesin e tyre, kopje të faturave të shpërndarësit farmaceutik, kopje të kërkesës së bërë nga drejtorja e IEVP-së për çdo furnizim, dhe t'i dorëzojë ato me procesverbalin

përkatës në datën _____ për periudhën nga data 16 deri në fund të muajit parardhës dhe datën _____ për periudhën nga data 1 deri më 15 të çdo muaji, por jo më vonë se tre ditë nga këto data, të dhënat dërgohen në DRF edhe në mënyrë elektronike ose online sipas programit.

Neni 7

Detyrimet e Shpërndarësit Farmaceutik

1. Shpërndarësi është i detyruar të furnizojë farmacinë e IEVP me barnat e LBR-së vetëm nëpërmjet transmetimit 100% në sistemin e-Depo, kundrejt kërkesës me shkrim të drejtorisë së IEVP dhe ta shoqërojë mallin me faturën (fletë-daljen) përkatëse.
2. Shpërndarësi është i detyruar të respektojë çmimet e shitjes me shumicë sipas çmimeve të parashikuara në LBR që është në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës. Ndryshimet në çmime mund të bëhen vetëm me Vendim të Këshillit të Ministrave (në vijim “VKM”).
3. Shpërndarësi është i detyruar të mbajë në rregull dhe në mënyrë lehtësisht të verifikueshme dokumentacionin që lidhet me barnat objekt i kësaj kontrate si më poshtë:
 - a) Inventarin e gjendjes fizike të këtyre barnave në momentin e lidhjes së kontratës, si edhe inventarin në momentin e hyrjes në fuqi të Listës së Re të Barnave që rimbursohen;
 - b) Faturat e hyrjes së barnave të rimbursueshme;
 - c) Fletëdalja e shpërndarësit farmaceutik duhet të jetë e fiskalizuar.
4. Shpërndarësi është i detyruar të pranojë verifikimin nga Fondit/DRF, për barnat e LBR, objekt i kësaj kontrate.
5. Shpërndarësi duhet të sjellë çdo muaj pranë DRF, (përfshirë shpërndarësit farmaceutik të Tiranës të cilët të dhënat i dorëzojnë në Fond) informacion elektronikisht për hyrjet dhe daljet e barnave sipas programit të Fondit.
6. Shpërndarësi duhet të tregëtojë barnat e LBR-së vetëm të pajisura me pullën e kontrollit të AKBPM dhe brenda serisë dhe skadencës së deklaruar.
7. Shpërndarësi është i detyruar që t'i kthejë Fondit shumën e xhiruar tepër (vlerën e diferencës në plus), të evidentuar nga kontrollet sipas kësaj kontrate.

Neni 8

Detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Fondit

DRF është e detyruar:

1. Të pajisë IEVP me dispozitat ligjore e nënligjore dhe t'i bëjë të ditur në mënyrë të qartë të gjitha rregullat dhe udhëzimet e reja që lidhen me objektin e kësaj kontrate.

2. Të pajisë IEVP (mjekun dhe farmacinë) me LBR, programin kompjuterik, protokollet e përdorimit të barnave, recetat tip me rimbursim dhe aktet normative të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tij në zbatim të kontratës.
3. Të sqarojë mjekun dhe farmacinë për çdo paqartësi lidhur me LBR dhe të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e kontratës.
4. Të kontrollojë aktivitetin e mjekut si dhe qarkullimin e barnave me rimbursim, si pranë shpërndarësit ashtu edhe pranë farmacisë IEVP, në zbatim të detyrimeve të kontratës. DRF duhet ta njoftojë paraprakisht IEVP për kontrollin që do të ushtrojë, sipas udhëzuesve standartë të kontrollit.
5. DRF merr në dorëzim nga farmacia IEVP recetat me rimbursim me listë treguesit e tyre me procesverbal në datën e caktuar.
6. DRF duhet të bëjë likuidimin (rimbursimin) e shumës sipas listë-treguesve dhe recetave të paraqitura nga farmacia IEVP, në llogarinë bankare të shpërndarësit që ka kryer furnizimin, brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tyre, bazuar në çmimin e shpërndarësit (depo) të alternativave të para të barnave sipas LBR.
7. DRF në bazë të kërkesës së IEVP duhet të njoftojë DRF e rajonit përkatës ku kanë patur vendbanimin e mëparshëm personat objekt i kësaj kontrate. DRF përkatëse duhet të njoftojë Qendrat Shëndetësore (në vijim “QSH”) dhe mjekët për të bërë ndryshimet e duhura në regjistrat themeltar.
8. DRF është e detyruar t’i japë të dhëna shpërndarësit farmaceutik lidhur me konsumin e barnave sa herë që i kërkohet.

Neni 9 **Gjoha**

1. Pas çdo kontrolli të ushtruar nga Fondi/DRF, në bazë të shkeljeve të konstatuara, organi që ushtron kontrollin gëzon të drejtën t’i rekomandojë organeve drejtuese të IEVP masat e karakterit, administrative (gjobë), penaltete dhe detyrim shpërblimi dëmi.
2. Drejtori i IEVP mban përgjegjësi për përcaktimin e përgjegjësi individuale dhe zbatimin e këtyre masave:
 - a) Në rastet e shkeljeve të pikave 3, 4, 6, 7, 8, 10, të nenit 4, “Detyrimet e mjekut të IEVP mbi kryerjen e vizitës dhe plotësimin e dokumentacionit”, vendoset gjobw 1,000 lekë për çdo rast;
 - b) Për shkeljen e pikës 5, të nenit 4 “Detyrimet e mjekut të IEVP mbi kryerjen e vizitës dhe plotësimin e dokumentacionit”, vendoset gjobw nga 10,000 – 30,000 lekë, e përshkallëzuar në varësi të shkeljes;
 - c) Për shkeljen e pikës 9, të nenit 4 “Detyrimet e mjekut për kryerjen e vizitës dhe plotësimin e dokumentacionit”, merren masa për kthimin e vlerës së plotë të dëmit ekonomik të shkaktuar;

- d) Për shkeljen e pikave 1-6, të nenit 5 “Detyrimet e mjekut për lëshimin e recetës” përcaktohet përgjegjësia individuale dhe merret gjobw në vlerën 1,000 lekë për çdo pikë të shkelur;
- e) Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave objekt i kësaj kontrate në farmacinë IEVP-së rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara (mospërputhje të gjëndjes fizike me atë kontabël) farmacia paguan vlerën në masë të barabartë me totalin e tepricës së konstatuar;
- f) Kur nga kontrolli me inventarizim i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në minus (gjendja fizike është më e vogël se gjendja kontabël), të pajustificuara mbi 20,000 lekë (për çdo kontroll), farmacia (drejtuesi teknik) paguan gjobw në masën 10,000 lekë;
- g) Në rast se faturat e shitjeve nuk janë të fiskalizuara, nuk do të merren në konsideratë nga kontrolli i ushtruar nga Fondi dhe nuk do t’u njihet subjekteve (shpërndarësit farmaceutik, Farmacisë IEVP) si të tilla;
- h) Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave të rimbursueshme objekt i kësaj kontrate, tek shpërndarësi farmaceutik i barnave rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara (gjendja fizike më e madhe se gjendja kontabël) shpërndarësi farmaceutik paguan gjobë të barabartë me dyfishin e tepricës së konstatuar.

Neni 10

Ankimi Administrativ

1. Subjekti ose personi përgjegjës ndaj të cilit është vendosur një sanksion sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë KSHA-së të Fondit, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni e vendimit me sanksionin përkatës.
2. Ankimi administrativ duhet të përmbajë këto elemente:
 - a. subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij;
 - b. procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi;
 - c. një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse;
 - d. pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
 - e. provat dhe dokumentacionin përkatës të cilat kërkohen të shqyrtohen nga KSHA.
3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton brenda 30 ditëve ankimin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.
4. Ankimi administrativ i paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e KSHA.
5. Kundër vendimit të KSHA subjekti mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët kontraktuese respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Palët kontraktuese të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Nëse palët kontraktuese apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ku ushtron aktivitetin.

Neni 12

Ndryshimet e kontratës

1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim, me vullnetin dhe pëlqimin e të treja palëve.
2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga palët kontraktuese/përfaqësuesit e autorizuar të të treja palëve.

Neni 13

Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë lidhet me deri ne hyrjen ne fuqi te LBR se re. Ky afat mund të ndryshojë me miratimin e përbashkët me shkrim të palëve.
2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj nga data _____ .
3. Kjo kontratë është përpiluar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje.
4. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar.

Kjo kontratë firmoset nga:

Për DREJTORINË RAJONALE TË FONDIT _____

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të DRF

Për Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale _____

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të IEVP

Për SHPËRNDARËSIN FARMACEUTIK _____

..... Emri, Mbiemri dhe firma e personit fizik/ortak i
vetëm/administrator/përfaqësues ligjor